



Republika e Maqedonisë së Veriut

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut



KOMITETI NACIONAL
PËR PARANDALIMIN
E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM
DHE LUFTË KUNDËR TERORIZMIT

STRATEGJIA KOMBËTARE PËR PARANDALIMIN E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM

2023-2027

TERMINOLOGJIA	3
PARATHËNIE.....	4
1. HYRJE	5
2. PËRCAKTIMET TONA PËR PARANDALIMIN E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM.....	7
3. PROCESI I PËRGATITJES DHE STRUKTURA E STRATEGJISË	7
4. QËLLIMI I PËRGJITHSHËM, MISIONI, VIZIONI	8
QËLLIMI	8
VIZIONI	8
MISIONI	8
5. PARIMET UDHËHEQËSE	9
6. ANALIZA E GJENDJES	11
6.1 Anët e forta.....	11
6.2 Ndikimet dhe mjedisi	12
6.3 Sfidat dhe mundësitë	13
7. FAKTORËT DHE SHTYTËSIT E PËRBASHKËT PËR PARANDALIMIN E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM DHE LUFTËN KUNDËR TERRORIZMIT	15
8. PRIORITETET STRATEGJIKE	15
9. QËLLIMET DHE MASAT STRATEGJIKE	17
1.PARANDALIMI	17
QËLLIMI STRATEGJIK 1.1 Ngritja e kapaciteteve institucionale.....	17
QËLLIMI STRATEGJIK 1.2 Ngritja e ndërgjegjësimit publik	18
QËLLIMI STRATEGJIK 1.3 Komunitete të forcuara dhe rezistente.....	18
QËLLIMI STRATEGJIK 1.4 Parandalimi i online radikalizimit në internet qe shtye drejt terrorizmit	19
2.MBROJTJA.....	20
Qëllimi strategjik 2.1 Institucione proaktive për mbrojtjen e vlerave themelore, të drejtave dhe lirive të njeriut dhe besim të rritur të qytetarëve në institucione.....	20
3.REALIZIMI	21
Qëllimi STRATEGJIK 3.1 Masat për mbrojtjen e kufirit.....	21
4.PËRGJIGJJA	21
Qëllimi strategjik 4.1 Deradikalizimi	21
QËLLIMI STRATEGJIK 4.2 Riintegrimi përmes risocializimit dhe rehabilitimit	22
QËLLIMI STRATEGJIK 4.3 Përforsimi i koordinimit dhe avancimi i bashkëpunimit.....	22
10.PRIORITETE PËR T’U REALIZUAR.....	23
11.MONITORIMI DHE VLERËSIMI	24
LISTA E SHKURTESAVE	26

TERMINOLOGJIA ¹

Ekstremizmi i dhunshëm dhe Radikalizimi që shpie drejt terrorizmit²

Një proces dinamik në të cilin një person pranon dhunën terroriste si një kurs veprimi të mundshëm dhe madje legjitim. Edhe pse jo domosdoshmërisht, kjo mund ta shtyjë personin të përfshihet në aktivitete terroriste, të veprojë në mbështetje të tyre ose të përfshihet në realizimin e tyre.

Komuniteti	Përfaqëson gra, burra, grupe shoqërore dhe institucione që janë të vendosura në të njëjtën zonë dhe/ose kanë interesa të përbashkëta. ³
Familja	Bashkësi e prindërve dhe fëmijëve dhe të afërmeve të tjerë, nëse jetojnë në një familje të përbashkët. ⁴
Gjuha e urrejtjes	Të gjitha format e shprehjes që përhapin, promovojnë, nxisin ose arsyetojnë urrejtjen e bazuar në jotolerancë ndaj një ose më shumë personave për shkak të karakteristikave të tyre personale ose përkatësisë së tyre në një grup të caktuar.
Luftëtarë të huaj terroristë (LHT)	Persona që udhëtojnë në një vend tjetër nga vendi i tyre i banimit ose shtetësisë për të kryer, planifikuar, përgatitur ose marrë pjesë në akte terroriste ose për të ofruar ose pranuar trajnime terroriste, përfshirë edhe në lidhje me një konflikt të armatosur. ⁵
Persona të rikthyer	Persona që largohen nga vendi i pritjes në vendin e origjinës, vendin e kombësisë ose vendbanimin e zakonshëm pasi të kenë kaluar një periudhë të konsiderueshme të kohës në vendin e pritjes, qoftë si vullnetar apo të detyruar, të ndihmuar apo në mënyrë spontane.
Mosangazhimi/përrjashtimi	Është një proces social dhe psikologjik ku angazhimi dhe përfshirja e individit në ekstremizmin e dhunshëm zvogëlohet në një shkallë në të cilën ai/ajo nuk rrezikohet më nga përfshirja në aktivitete të dhunshme. Ky proces përfshin një ndryshim në sjellje (nuk përdor ose arsyeton më përdorimin e dhunës), mirëpo nuk përfshin domosdoshmërisht një ndryshim në angazhimin e individit ndaj një kauze të veçantë radikale ose ekstremiste.
Deradikalizimi	Është procesi i ndryshimit të sistemit të besimit të një individi në mënyrë që ai/ajo të refuzojë ideologjinë e dhunshme ekstremiste dhe të pranojë vlerat kryesore, jo të dhunshme. Kjo nënkupton një ndryshim thelbësor që ndodh si rezultat i veprimeve të ndërmarra për të ndihmuar individët të heqin dorë nga idetë, besimet dhe grupet radikale ose ekstreme që kanë lidhje me dhunën.

¹ Termat "ekstremizëm i dhunshëm" dhe "radikalizim drejtë dhunës" përputhen me Kornizën e Konsoliduar të OSBE-së për Kundër Terrorizmit (PC.DEC/1063) dhe Strategjinë e OKB-së për Kundër-Terrorizmin Global (Shqyrtimi i 7-të A/RES/75/291, 2 korrik, 2021)

² Terminologjia "Ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizimi që çon në terrorizëm" është në përputhje me Deklaratën Ministrore për Forcimin e Përpjekjeve të OSBE-së për Parandalimin dhe Luftimin e Terrorizmit, miratuar në Takimin Ministror të Dhjetorit 2016 (MC.DOC 1/16)

³ Roli i Shoqërisë Civile në Parandalimin dhe Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizimit që Çon në Terrorizëm: Një Udhëzues për Evropën Juglindore, OSBE

⁴ Ligji mbi Familjen (teksti i konsoliduar) "Fletorja Zyrtare e RM" numër 153/2014

⁵ Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 2178 (2014) S/RES/2178.

Rehabilitimi	Është një proces pas së cilit njerëzit janë në gjendje të bëjnë një jetë të vetë-përcaktuar dhe të vetë-qëndrueshme dhe të mos kenë më qëndrime ekstremiste që mund të përbëjnë rrezik për veten ose shoqërinë (rimëkëmbje fizike dhe mendore.)
Risocializimi	Kthimi në sjelljen dhe normat e pranuar nga shoqëria.
Riintegrimi	Është një tranzicion i sigurt dhe drejt brenda komunitetit, me të cilin individ i vazhdon të jetojë në përputhje me Ligjin, përfshirë edhe pas lirimit të tij/saj nga burgu, përkatësisht një proces i lidhjes sociale (miqësia, familja dhe komuniteti) dhe funksionale (kushtet për strehim, punësim, punë, kujdes shëndetësor) me shoqërinë.

PARATHËNIE

Të vetëdijshëm për sfidat bashkëkohore të sigurisë në vend, rajon, në Evropë dhe në botë.

Të nxitur nga nevoja për të zhvilluar politika dhe praktika për të parandaluar dhe luftuar ekstremizmin e dhunshëm që mund të shpie në terrorizëm.

Të përkushtuar për ndërtimin e një shoqërie rezistente ndaj radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm që mund të çojë në terrorizëm sepse terrorizmi është pasoja më ekstreme e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Të përgatitur për të zbatuar praktikën më të mira evropiane dhe globale për parandalimin e radikalizimit dhe parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në përputhje me ligjet ndërkombëtar të të drejtave të njeriut, ligjin ndërkombëtar për refugjatët dhe të drejtën ndërkombëtare humanitare.

Të bindur se vetëm nëpërmjet përgjigjes së agjencive shumëpalëshe do të sigurohet parandalim efektiv, ne mbështesim, forcojmë dhe mbrojmë kolektivisht vlerat tona demokratike dhe themelore kundër atyre që kërkojnë t'i cenojnë ato. Për këtë gjë duhet të investojmë në kohezionin social, arsimin dhe shoqëritë gjithëpërfshirëse ku secili ndjen se respektohet identiteti i tij/saj dhe se i përkasin plotësisht komunitetit.

Duke pranuar rolin udhëheqës të Kombeve të Bashkuara në përpjekjet ndërkombëtare kundër terrorizmit dhe duke miratuar Strategjinë e OSBE-së për adresimin e kërcënimeve ndaj sigurisë dhe stabilitetit në shekullin XXI, e cila e identifikon terrorizmin si një nga shkaqet më të rëndësishme të jostabilitetit të sigurisë në mjedisin aktual.

Duke pasur parasysh kontributin, KNPEDhLKT-ja shpreh mirënjohjen e tij për të gjithë partnerët ndërkombëtar, rajonal dhe vendas, organizatat qeveritare dhe joqeveritare që siguruan mbështetje për përgatitjen e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm.

1. HYRJE

Ekstremizmi i dhunshëm është një problem kompleks i sigurisë që nuk njihet kufij, kultura, fe apo grupe etnike. Ai është një fenomen që na prek të gjithëve dhe kërkon një përgjigje të integruar për parandalim.

Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit paraqet bazën për mbrojtjen e shoqërisë nga aktet terroriste, në radhë të parë sepse ekstremizmi i dhunshëm dhe terrorizmi janë rezultat i një procesi individual ose kolektiv të radikalizimit që shpie drejt arsyesimit të dhunës për të arritur qëllime të caktuara (politike, ideologjike, sociale).

Në rezolutën 2178 (2014), Këshilli i Sigurimit shpjegon qartë lidhjen ndërmjet ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit, thekson rëndësinë e masave për të qenë në përputhje me normat ndërkombëtare dhe njihet nevojën për parandalim: "ekstremizmi i dhunshëm, i cili mund të jetë i përshtatshëm për terrorizëm" kërkon përpjekje kolektive, "duke përfshirë parandalimin e radikalizimit, rekrutimin dhe mobilizimin e individëve në grupe terroriste, si dhe shndërrimin e tyre në luftëtarë të huaj terroristë".

Planifikimi strategjik i masave dhe aktiviteteve për parandalimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm janë një prioritet kryesor në procesin e ndërtimit të komuniteteve të sigurta dhe rezistente, si dhe në garantimin e vlerave bazë si sundimi i shtetit të së drejtës, të drejtat dhe liritë e njeriut, siguria e qytetarëve, vlerat kulturore dhe gjithëpërfshirja e shoqërisë.

Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që shpie në terrorizëm është një nga sfidat kryesore që kërkon:

- ⇒ njohuri, përkatësisht të kuptuarit e fenomenit,
- ⇒ njohje/identifikim të rreziqeve që tërheqin dhe faktorëve që motivojnë,
- ⇒ njohuri se çfarë duhet të bëjmë kur rriten rreziqet që rrisin mundësinë e radikalizimit dhe njohuri për masat e përshtatshme për menaxhimin e rreziqeve.
- ⇒ perceptimi ose analizimi i ndikimit të gjinisë për mundësitë, rolet shoqërore dhe ndërveprimet e njerëzve. Kjo mënyrë vështrimi bën të mundur bërjen e një analize gjinore dhe më pas përfshirjen e perspektivës gjinore në çdo program të propozuar, politike apo organizatë.

Strategjia për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm nxit pjesëmarrjen, gjithëpërfshirjen sociale dhe barazinë e të gjithë qytetarëve.

Në këtë drejtim, është marrë parasysh mendimi i fundit i Komitetit Këshillëdhënës të Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (FCNM) të Këshillit të Evropës, duke rekomanduar urgjentisht që shteti "të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për të ndërtuar një shoqëri të integruar që është fuqimisht e bazuar në shtetin e së drejtës, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat e pakicave, respektimin e diversitetit, si dhe në hedhjen poshtë të politikës ekskluzivisht etno-nacionaliste që forcon më tej formimin e shoqërive paralele".⁶

⁶ Strategjia kombëtare për zhvillimin e konceptit të një shoqërie dhe ndërkulturalizmit 2020-2022, e qasshme në: <https://vlada.mk/nacionalni-strategii>

Me Strategjinë për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm, Republika e Maqedonisë së Veriut shpreh zotimin e saj të fuqishëm për zhvillimin dhe përmirësimin e koncepteve për luftimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm që mund të çojë në terrorizëm. Strategjia për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm 2023-2027 është vazhdimësi e strategjisë së mëparshme, duke marrë parasysh nevojën për qëndrueshmëri të zgjidhjeve dhe nevojën për intervenim afatgjatë. Në fushëveprimin e saj, Strategjia merr parasysh sfidat dhe ndikimet e reja, për të cilat janë planifikuar masa të duhura të intervenimit.



Krijimi i një shoqërie të barabartë, gjithëpërfshirëse dhe pluraliste, bazuar në respektimin e plotë të të drejtave të njeriut dhe mundësive ekonomike për të gjithë, paraqet mënyrën më efektive për eliminimin e ekstremizmit të dhunshëm.

Toleranca dhe të kuptuarit e ideve dhe kulturave të ndryshme janë në fokusin e Agjendës së Zhvillimit të Qëndrueshëm të UNDP-së (2030). Qëllimi i Zhvillimit të Qëndrueshëm i obligon shtetet të "promovojnë shoqëri paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, të sigurojnë qasje në drejtësi për të gjithë dhe të ndërtojnë institucione efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet". Duke u përqendruar në çrrënjosjen e varfërisë, uljen e pabarazisë, promovimin e vlerave të bazuara në respektimin e diversitetit dhe veprimin pa diskriminim, duke vendosur një kornizë të gjerë veprimi i cili duhet të parandalojë ekstremizmin e dhunshëm.

2. PËRCAKTIMET TONA PËR PARANDALIMIN E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM

Republika e Maqedonisë së Veriut është një partner i besueshëm në luftën kundër terrorizmit dhe anëtar i Koalicionit Global për të mposhtur ISIS-in. Në këtë drejtim, ajo mbështet fuqishëm rolin e NATO-s në luftën e komunitetit ndërkombëtar kundër terrorizmit.

RMV-ja ka firmosur dhe ratifikuar të gjitha konventat e Kombeve të Bashkuara kundër terrorizmit, si dhe protokollet e lidhura me terrorizmin, duke përfshirë Rezolutën 2178 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së (2014) dhe Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin e Terrorizmit.

Duke respektuar detyrimet e Planit të Përbashkët të Veprimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor për luftën kundër terrorizmit, Qeveria e RMV-së miratoi planin kombëtar për riintegrimin, risocializimin dhe rehabilitimin e të rikthyerve nga ushtritë e huaja dhe anëtarëve të familjeve të tyre (gratë dhe fëmijët).

Procedurat Standarde të Veprimit për riintegrimin, risocializimin dhe rehabilitimin e luftëtarëve të huaj dhe anëtarëve të familjeve të tyre e operacionalizojnë procedurën, e cila bazohet në vlerat themelore për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, një qasje gjithëpërfshirëse, qasje dhe trajtim individual dhe parimin e konfidencialitetit.

3. PROCESI I PËRGATITJES DHE STRUKTURA E STRATEGJISË

Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm është një dokument i përbashkët i përfaqësuesve të institucioneve qeveritare, shoqatat e qytetarëve, komunitetit akademik dhe ndërkombëtar.

Nëpërmjet diskutimeve në debate të organizuara u përcaktuan prioritetet dhe qëllimet strategjike, të cilat rezultuan nga analiza e kontekstit të paraqitur duke përcaktuar sfidat dhe mundësitë kryesore për një reagim të duhur parandalues dhe proaktiv të shtetit në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe procesit të radikalizimit që mund të shpie në terrorizëm.

Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm është hartuar për një periudhë 5-vjeçare (2023 – 2027), pas së cilës proceset do të rishqyrtohen dhe do të bëhet analizë për hapat e mëtejshëm. Dokumenti përbëhet nga katër (4) prioritetet strategjike dhe nëntë (9) qëllime strategjike që janë rezultat i analizës së situatës duke përfshirë aktivitete që janë në funksion të arritjes së qëllimeve dhe prioritetëve strategjike (të paraqitura në Planin e Veprimit).

Strategjia kombëtare inkurajon një qasje të gjerë shoqërore dhe një përgjigje multidisciplinare në procesin e parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm, me qëllim që të sigurohet përfshirja e një game të gjerë aktorësh qeveritarë si përfaqësues nga departamentet e sigurisë, çështjeve sociale, arsimit, shëndetësisë, rinisë dhe sport, përfaqësues të shoqërive civile, si dhe përfshirjen e të rinjve, familjeve, grave, drejtuesve fetarë, kulturorë dhe arsimorë si dhe mediave.

Me këtë qasje sigurohet përfshirja aktive e të gjitha subjekteve përkatëse në procesin e planifikimit strategjik të hapave të ardhshëm që do të ndërmerren nga aktorët shtetërorë dhe joshtetërorë në

procesin e parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm, si dhe në reagimin përmes zhvillimit të programe të veprimit në fushën e parandalimit parësor, dytësor dhe terciar.

4. QËLLIMI, MISIONI DHE VIZIONI

Me këtë dokument strategjik, Qeveria RMV-së dëshiron të përmirësojë përpjekjet për të luftuar radikalizimin dhe ekstremizmin e dhunshëm që mund të çojë në terrorizëm. Terrorizmi është pasoja më ekstreme e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Për këto arsye, me qëllim parandalimin e terrorizmin, veprimet parandaluese paraqesin një element kryesor për të siguruar vlerat themelore si demokracinë, të drejtat e njeriut dhe sigurinë.

Gjithëpërfshirja e shoqërisë sonë është mbrojtja jonë më e fortë kundër kërcënimit të terrorizmit. Agjenda jonë duhet të përqendrohet në ndërtimin e komuniteteve rezistente që mund t'i rezistojnë radikalizimit dhe të mbrojnë vlerat e rendit tonë kushtetues.⁷

Ndërtimi i marrëdhënieve dhe promovimi i komuniteteve rezistente paraqet një faktor në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit.

QËLLIMI

Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm synon ruajtjen e vlerave të tolerancës dhe harmonisë fetare, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, sundimin e shtetit të së drejtës dhe demokracisë, si dhe mbrojtjen e shoqërisë nga ekstremizmi i dhunshëm.

VIZIONI

Një shoqëri e aftë për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin që shpie në terrorizëm.

MISIONI

Kundërshtimi dhe parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm përmes programeve dhe politikave të bazuara në fakte për të identifikuar rreziqet dhe për të ndërhyrë me qëllim zvogëlimin dhe eliminimin e ndikimit të tyre.

⁷ Strategjia kombëtare për Zhvillimin e konceptit për një shoqëri dhe ndërkulturalizmit (2020-2022)

5. PARIMET UDHËHEQËSE

TË VEPRUARIT NGA PIKËPAMJA E TË DREJTAVE DHE LIRIVE TË NJERIUT

Të drejtat dhe liritë e njeriut janë vlerë themelore e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa respektimi dhe promovimi i tyre paraqet një domosdoshmëri për çdo shtet demokratik. Deklarata Universale e Kombeve të Bashkuara, dokumentet e Këshillit të Evropës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe shumë dokumente të tjera për punën e autoriteteve të zbatimit të ligjit, përcaktojnë nevojën që të vepruarit nga pikëpamja e të drejtave dhe lirive të njeriut të jetë edhe parimi i parë udhëheqës i strategjive të reja kombëtare mbi PEDh dhe LKT. Të vepruarit nga pikëpamja e të drejtave dhe lirive të njeriut bazohet në parimet e mëposhtme të veprimit:

- Pjesëmarrje në procesin e vendimmarrjes (secili ka të drejtë të marrë pjesë aktive në proceset vendimmarrëse që ndikojnë në ushtrimin e të drejtave të tyre);
- Llogaridhënie (në rastet kur ndodhin shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nevojiten mjete juridike efektive);
- Mosdiskriminim dhe barazi (çdokush ka të drejtën e qasjes së barabartë në të drejtat dhe liritë e njeriut pa asnjë diskriminim);
- Inkurajim dhe fuqizim (secili ka të drejtë të ketë qasje dhe të realizojë të drejtat e tij). Individët dhe komunitetet duhet t'i njohin të drejtat e tyre dhe të marrin pjesë në krijimin e politikave që ndikojnë në jetën e tyre, ndërsa autoritetet kompetente shtetërore kanë detyrim të respektojnë, mbrojnë dhe mundësojnë të drejtat e njeriut);
- Ligjshmëri (të gjitha procedurat e institucioneve duhet të jenë në përputhje me të drejtën kombëtare dhe ndërkombëtare).
- Mbikëqyrja efektive, kontrolli i rregullt dhe monitorimi i pavarur i përputhshmërisë së veprimeve të shtetit me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut

QEVERISJA E MIRË DHE RUAJTJA E VLERAVE DEMOKRATIKE

Qeverisja e mirë nënkupton menaxhimin e duhur të shtetit, shoqërisë dhe burimeve. Ajo synon mbrojtjen e interesave, të drejtave sociale, ekonomike dhe politike të njerëzve pa diskriminim mbi asnjë bazë.

Karakteristikat themelore të qeverisjes së mirë janë pjesëmarrja, shteti i së drejtës, transparenca, përgjegjësia, barazia dhe gjithëpërfshirja, efektiviteti dhe efikasiteti i veprimeve, si dhe llogaridhënia e institucioneve.

QASJA E GJERË QEVERTARE DHE SHOQËRORE

Strategjia bazohet në parimin e një qasjeje të gjerë shoqërore dhe qeveritare, duke bashkuar të gjitha institucionet qeveritare dhe shoqatat përkatëse të qytetarëve në interes të mbrojtjes së qytetarëve nga radikalizimi dhe ekstremizmi i dhunshëm që shpie drejt terrorizmit.

Nevojitet një qasje gjithëpërfshirës, i integruar, ndërdisiplinor dhe ndërinstitutional i institucioneve në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. Komiteti Kombëtar për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftimin e Terrorizmit (KKPEDhLKT) ruan funksionin parësor të koordinimit të institucioneve në realizimin e katër prioritetëve strategjike (parandalimin, mbrojtjen, realizimin dhe përgjigje(reagimin)).

MUNDËSI TË BARABARTA PËR GRATË DHE BURRAT

Barazia e plotë e grave dhe burrave nënkupton të drejta, mundësi, kushte dhe trajtim të barabartë në të gjitha fushat e jetës publike dhe private, si dhe mungesë të kushteve kulturore, sociale, ekonomike dhe politike që krijojnë marrëdhënie të pabarabarta pushteti dhe shpërndarje të pabarabartë të të mirave shoqërore ndërmjet grave dhe burrave;⁸

Organet kompetente shtetërore të ngarkuara për luftimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit zotohen, në masën më të lartë të mundshme, të promovojnë parimin e mundësive të barabarta ndërmjet grave dhe burrave. Përveç kësaj, shumë rezoluta dhe dokumente të OKB-së kanë njohur rëndësinë e rritjes së përfshirjes së grave në forcimin e dimensioneve gjinore të parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që shpie në terrorizëm. Rezoluta e gjashtë e Asamblesë së Përgjithshme mbi Strategjinë Globale Kundër Terrorizmit, e miratuar në qershor 2018, thekson rolin e rëndësishëm të grave në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe nevojën për të integruar analizën gjinore në programet që synojnë trajtimin e nxitësve të radikalizimit.

NDALIMI I DISKRIMINIMIT KUNDËR ÇDO PERSONI DHE/OSE GRUPI PERSONASH NË BAZË TË KARAKTERISTIKAVE TË TYRE PERSONALE, NË VEÇANTI GRUPEVE TË CENUESHME SHOQËRORE

Ndalimi i diskriminimit është një vlerë që paraqet bazë për veprimet e institucioneve demokratike. Organet e sigurisë (policia dhe shërbimet e tjera të sigurisë) janë bartësit e garancisë për atë se çdo person do të ketë të drejta të barabarta pa asnjë diskriminim, ndërsa grupet shoqërore të cenueshme do të trajtohen me vëmendje të veçantë në frymën e mirëkuptimit, respektit dhe mbështetjes së ndërsjellë.

LIGJSHMËRIA

Të gjitha veprimet dhe aktivitetet që planifikohen dhe ndërmerren janë në përputhje me Kushtetutën e RMV-së, legjislacionin, rregulloret tjera të miratuara në bazë të legjislacionit dhe marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare.

⁸ Ligji për Mundësi të Barabarta të Grave dhe Burrave “Fletorja Zyrtare e RM, nr. 201/2015

Të gjitha masat dhe aktivitetet nga plani strategjik që janë në funksion të parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që shpiejnë drejt terrorizmit, janë në përputhje me të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të drejtën ndërkombëtare për refugjatët dhe të drejtën ndërkombëtare humanitare.

Për parandalimin dhe parandalimin efektiv të ekstremizmit të dhunshëm, veprimi është në përputhje me respektimin e plotë të barazisë gjinore dhe veprim i drejtuar dhe i përshtatur me moshën e personave.

Çdo shkelle e ligjshmërisë duhet të kalojë përmes një sistemi që, nëpërmjet mekanizmave të duhur ligjorë, do të korrigjojë sjelljen e zyrtarëve përgjegjës për zbatimin e ligjeve.

RESPEKTIMI I ASPEKTEVE SHUMË-ETNIKE DHE SHUMË-KULTURORE TË SHOQËRISË

Multikulturalizmi nënkupton një vizion të një shoqërie që do të përfshijë grupe të ndryshme kulturore me diversitetin e tyre kulturor në të gjitha fushat e jetës shoqërore. Në kuadër të komuniteteve multikulturore, njerëzit ruajnë, përcjellin, festojnë dhe ndajnë mënyrat unike kulturore të jetës; gjuhët, artet, traditat dhe sjelljet e tyre.

BASHKËPUNIMI RAJONAL DHE NDËRKOMBËTAR

Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm është i mundur vetëm nëpërmjet bashkëpunimit dhe koordinimit të të gjitha subjekteve të rëndësishme në nivel kombëtar. Bashkëpunimi rajonal është thelbësor veçanërisht duke pasur parasysh se kërcënimet nga ekstremizmi i dhunshëm nuk njohin kufij dhe shpesh janë transnacionale.

Bashkëpunimi ndërkombëtar është imperativ kur bëhet fjalë për kërcënime që tejkalojnë kufijtë e një vendi apo rajoni dhe që nuk lidhen me një kulturë, fe, besim apo përkatësi tjetër specifike.

Problemi i ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit nuk fillon dhe mbaron vetëm në një vend apo vetëm në një rajon. Përkundrazi, bota po përballet me këtë sfidë dhe për këtë arsye nuk është e mundur që një vend të përballet me këtë në mënyrë të pavarur dhe të arrijë sukses të jashtëzakonshëm. Problemet janë ndërkombëtare, sfidat globale. Kjo është arsyeja pse përgjigjja duhet të jetë gjithëpërfshirëse dhe të përfshijë shkëmbimin e informacioneve, përvojave, njohurive dhe aftësive në nivel ndërkombëtar.

6. ANALIZA E GJENDJES

Për planifikimin e duhur strategjik, është bërë një analizë e bazuar në të dhënat statistikore, mësimet e mëparshme të nxjerra, analiza e gjendjes (shkencore dhe operative) dhe njohuritë e praktikuesve. Në këtë drejtim, janë marrë parasysh anët e forta që dalin nga gjendja aktuale, sfidat që ndërlidhen me rreziqe të caktuara dhe mundësitë për planifikimin e duhur të aktiviteteve të reja.

6.1 Anët e forta

Duke ndjekur tendencat e përgjithshme, strategjia e re merr parasysh anët e forta që mund të zvogëlojnë dukshëm rreziqet e radikalizimit që shpiejnë drejt terrorizmit dhe shfaqjen e lëvizjeve ekstremiste.

Kur flitet për anët e forta, merren parasysh disa pikëpamje të cilat kanë të bëjnë me:

- Vazhdimësinë e procesit të planifikimit strategjik. Strategjia monitoron procesin e realizimit dhe mësimet e nxjerra nga zbatimi i planit të veprimit për zbatimin e strategjisë së parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm 2018-2022.
- Është krijuar një kuadër institucional për bashkërendimin e aktiviteteve në nivel kombëtar dhe vendor. Komiteti Kombëtar për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftimin e Terrorizmit ka ngritur kapacitetet e tij dhe merr pjesë aktive në krijimin e politikave në fushën e parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm. Në nivel kombëtar, është krijuar një Grup Ndërinstitucional Pune për monitorimin e procesit të rehabilitimit, risocializimit dhe riintegritit të LHT-ve dhe anëtarëve të familjeve të tyre. Në nivel lokal, janë krijuar nëntë(9) Ekiye Lokale Multidisiplinare - ELM, të cilat janë të përfshira në punën me LHT-të dhe anëtarët e familjeve të tyre, si dhe janë formuar gjashtë(6) Ekiye të Veprimit në Komunitet - EVK, të cilat kanë hartuar planet e tyre të veprimit.
- Është vendosur bashkëpunim me shoqatat përkatëse të qytetarëve që janë bërë partnerë aktiv në procesin e parandalimit, rehabilitimit, risocializimit dhe riintegritit të personave të radikalizuar.
- Është vendosur bashkëpunim në nivel rajonal dhe ndërkombëtar.⁹
- Shoqëria jonë kultivon vlerën themelore të karakterit shumë-kulturor, shumë-etnik dhe shumë-fetar. Vendosmëria për të kultivuar këtë karakter konfirmohet nga Vizioni i Strategjisë Kombëtare për Një Shoqëri dhe Inter-kulturalizëm 2020-2022. “Për ne, Një shoqëri për të gjithë nënkupton: njohja e të gjithë dallimeve, garantimi dhe siguri i barazisë, drejtësisë sociale, mundësive të barabarta për gratë dhe burrat, përfshirjen dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes dhe arritjen e kohezionit social”.
- Familja është ende qeliza bazë në familje, e cila ndikon dukshëm në ndërtimin e vlerave në komunitet.

6.2 Ndikimet dhe mjedisi

Korrupsioni si shtytësi kryesor i krimit të organizuar dhe krimit serioz përbën kërcënim për sigurinë e qytetarëve, cenon besimin në institucione, sundimin e shtetit të së drejtës dhe zhvillimin e kapaciteteve demokratike të shtetit. Megjithatë, konstatimi se "vendi ka arritur një nivel të caktuar gatishmërie/është mesatarisht i përgatitur në drejtim të **parandalimit dhe luftimit të korrupsionit**"¹⁰ është inkurajues.

Nga vlerësimi i kërcënimeve të krimit të organizuar dhe krimit serioz të vitit 2021, “ende nuk ka një lidhje sistematike të vendosur ndërmjet krimit të organizuar si burim i financimit të drejtpërdrejtë të aktiviteteve terroriste dhe ekstremiste radikale” megjithëse “për tre grupe, përkatësisht për disa nga anëtarët e tyre janë konstatuar lidhje me grupe ekstremiste”.

⁹ Përfshirë me OSBE, UNOCT, IOM dhe të tjerë.

¹⁰ Raporti për Maqedoninë e Veriut për vitin 2022, Dokumenti i punës i shërbimeve profesionale të Komisionit, Bruksel 12.10.2022, SVD (2022) 337 versioni i fundit.

Republika e Maqedonisë së Veriut, si vend me pozitë specifike gjeopolitike dhe gjeostrategjike, përdoret shpesh për lëvizjen e paligjshme të migrantëve. RMV-ja ndodhet në kryqëzimin e rrugëve të migrimit që burojnë nga Azia dhe Afrika në Evropën Qendrore dhe Perëndimore.

Standardi i jetesës së popullatës, si dhe menaxhimi i krizës ekonomike dhe energjetike ndikojnë dukshëm në kriminalitetin dhe mundësinë për të ndikuar më lehtë mbi grupet e cënueshme të qytetarëve.

Nevoja për digjitalizim, veçanërisht në fushën e aktiviteteve ndërinstitucionale, ka një ndikim të rëndësishëm në monitorimin e zbatimit të programeve për rehabilitim, risocializim dhe riintegrim.

Të rinjtë mbeten fokusi i parandalimit parësor. Është e nevojshme të sigurohet përfshirja e të rinjve në proceset vendimmarrëse të shtetit, pasi që integrimi dhe gjithëpërfshirja shoqërore përfaqësojnë një minimum të domosdoshëm dhe një parakusht pa të cilin nuk mund të sigurohet zhvillimi i integruar i çdo të riu.

Radikalizimi që shpie drejtë terrorizmit në burgje mbetet një shqetësim dhe nevojiten më shumë aktivitete në këtë drejtim.

6.3 Sfidat dhe mundësitë

Duke pasura parasysh anët e forta dhe ndikimet, me rëndësi për hartimin e strategjisë janë sfidat me të cilat duhet të përballemi në periudhën që është përfshirë në strategji.

Sfidat e përgjithshme për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm mbi të cilat bazohet strategjia e re kur bëhet fjalë për parandalimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm:

- **Interneti dhe rrjetet sociale si arenë virtuale për radikalizimin dhe përhapjen e gjuhës së urrejtjes.**

Personat që promovojnë pikëpamjet ekstremiste në internet gjejnë lehtësisht mbështetje për opinionet dhe pikëpamjet e tyre për shkak të shpejtësisë me të cilën përhapen mesazhet që përmbajnë gjuhë urrejtjeje dhe nxisin dhunë. Një sfidë serioze paraqet zbulimi i profileve të fshehura në internet përmes së cilave përcillen mesazhe të tilla, me çfarë njerëzit lehtësisht mund ta kalojnë rrugën e radikalizimit drejtë dhunës pa u zbuluar burimi. Kjo mënyrë komunikimi (audio ose video) me njerëz që ndajnë mendime të njëjta mund të paraqet një portë për radikalizën drejt dhunës. Nga ana tjetër, aktivitetet dhe ndikimi përmes internetit mund të intensifikojnë procesin e radikalizimit drejtë dhunës që ka filluar më herët.

- **Rrethanat ndërkombëtare kanë një ndikim të fuqishëm ndaj rreziqeve të radikalizimit drejt dhunës**

Rrethanat ndërkombëtare dhe konfliktet e jashtme kanë një ndikim të rëndësishëm në situatën e përgjithshme. Mësimet e fituara me qytetarët tanë që iu bashkëngjitën një ushtrie të huaj në ISIS, nuk përjashtojnë mundësinë që individët të motivohen për t'u përfshirë drejtpërdrejt në aktivitete ushtarake në konfliktin ushtarak ndërmjet Rusisë dhe Ukrainës.

➤ **Rreziku i rritjes së polarizimit ndërmjet grupeve të ndryshme.**

Polarizimi i komunitetit është një sfidë serioze që kontribuon në shfaqjen e grupeve të mbyllura që mund të promovojnë lehtësisht dhunën si një mundësi për të arritur qëllimet e tyre. Në mjedisin tonë, polarizimi i bazuar në përkatësinë etnike dhe fetare është ende dominues. Mirëpo, në kohët e fundit nuk është përjashtuar polarizimi brenda komuniteteve të njëjta etnike. Me këtë shoqëria jonë bëhet më pak kohezive dhe lehtësisht e ndjeshme ndaj ndikimeve të grupeve të ndryshme.

➤ **Përfshirja e LHT-ve dhe anëtarëve të familjeve të tyre në procesin e rehabilitimit, risocializimit dhe riintegritimit.**

Përvojën që e kanë fituar personat që kanë udhëtuar në zonat e konfliktit si pjesëmarrës në ushtri të huaja ose si anëtarë të familjes i bën ata më të aftë për të planifikuar dhe kryer akte terroriste. Nevojitet një përgjigje e fortë shoqërore në procesin e mosangazhimit/shkëputjes dhe riintegritimit të tyre në komunitet.

Megjithëse sistemi ligjor i RMV-së inkriminon dhe sanksionon pjesëmarrjen në formacione të huaja ushtarake, policore, paraushtarake apo parapolicore, ky fenomen vazhdon të përbëjë një rrezik sigurie. Një përgjigje më gjithëpërfshirëse institucionale është e nevojshme për të ndaluar ose parandaluar fenomenet aktuale dhe të ardhshme që mund të çojnë në radikalizëm dhe ekstremizëm të dhunshëm të cilat shiejnë drejt terrorizmit.

Përpyekjet e udhëhequra nga qeveria për riatdhesimin e shtetasve që kishin udhëtuar në Siri dhe Irak filluan në vitin 2018 me riatdhesimin e 7 shtetasve; vazhduan me riatdhesimin e 3 grave në vitin 2019 dhe në vitin 2021 janë riatdhesuar katër(4) burra, pesë(5) gra dhe katërmëdhjetë(14) fëmijë. Procesi i riintegritimit, risocializimit dhe rehabilitimit (RRR) zbatohet në përputhje me Planin Kombëtar për riintegrimin, risocializimin dhe rehabilitimin e të kthyerve nga ushtritë e huaja dhe anëtarëve të familjeve të tyre (gra dhe fëmijë) dhe Procedurat Standarde të Operacionit. Në procesin e përgjithshëm, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka një qasje holistike ndaj RRR për gratë dhe fëmijët e kthyer, e cila synon integrimin e tyre në komunat lokale përmes ndërhyrjeve individuale të përshtatura për secilën familje.

Duke pasur parasysh ndikimet dhe sfidat me të cilat përballemi, janë përcaktuar edhe mundësitë për ndërhyrje:

- ➔ Është e nevojshme të forcohen kapacitetet njerëzore dhe materiale në përballjen me proceset e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm që shpiejnë në terrorizëm;
- ➔ Nisur nga cënueshmëria, të rinjtë janë në fokus të synimeve strategjike të planifikuara të Strategjisë për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm 2023–2027;
- ➔ Forcimi i ndërgjegjësimit të publikut dhe bërja e fushatave me narrativa pozitive/alternative për personat/komunitetet vulnerabël;
- ➔ Ngritja e nivelit të edukimit mediatik për të gjithë qytetarët.
- ➔ Realizimi i nismave edukative që promovojnë paqen, diversitetin dhe tolerancën.
- ➔ Avancimi i programit për riintegrimin e LHT-ve dhe anëtarëve të familjeve të tyre.
- ➔ Zbatimi i procedurave të ndihmës para lirimit dhe pas lirimit nga burgu për personat e dënuar të radikalizuar.

- ⇒ Krijimi i një sistemi të monitorimit, koordinimit dhe evidentimit të asistencës dhe mbështetjes për personat e radikalizuar që përfshihen në programin e riintegrit nëpërmjet rehabilitimit dhe risocializimit, duke përfshirë LHT-të dhe anëtarët e familjeve të tyre (në sistemin e mbrojtjes sociale).

7. FAKTORËT DHE NXITËSIT E PËRBASHKËT PËR PARANDALIMIN E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM DHE LUFTËN KUNDËR TERRORIZMIT

Etiologjia e ekstremizmit të dhunshëm që mund të shpie në terrorizëm identifikohet me nxitësit – personal dhe shoqëror që kontribuojnë në radikalizimin e personave ose grupeve të caktuara në komunitet.

Fenomenologjia është e ndryshueshme dhe grupet e dhunshme ekstremiste po gjejnë mënyra të reja për të kryer sulmet e tyre, për të përhapur propagandën e tyre, për të financuar aktivitetet e tyre dhe për të rekrutuar njerëz në radhët e tyre.

Si shtytës të përbashkët që tërheqin dhe shtynë (push and pull factors) njihen:

- ✚ Të kthyerit - "luftëtarë terroristë të huaj" dhe anëtarë të familjeve të tyre¹¹ (dinamika reciproke dhe sociale midis LHT si dhe ndërmjet LHT dhe komunitetit);
- ✚ Narrativa të dhunshme ekstremiste të bazuara në fe ose lëvizje të ekstremit të djathtë ose etno-nacionalist;
- ✚ Diskriminimi ndikon në izolimin dhe marginalizimin më të madh të pjesëtarëve të komuniteteve më të vogla etnike ose grupeve fetare;
- ✚ Konfliktet e ngjira "kronike" në rajon kanë ndikim të tërheqin drejt procesit të radikalizimit që shpie drejt terrorizmit.
- ✚ Krimi i organizuar dhe korrupsioni që krijojnë mosbesim në institucione;
- ✚ Faktorët ekonomik (standardi ulët i jetesës, kriza botërore ekonomike dhe energjetike);

8. PRIORITETET STRATEGJIKE

Pikënisja e kësaj strategjie është të mësojmë nga strategjia e fundit, duke qenë të vetëdijshëm se kemi nevojë për një fokus më të madh në qëndrueshmërinë, në ndërtimin e marrëdhënieve, ndarjen e njohurive dhe promovimin e vlerave.

Strategjia për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm që mund të çojë në terrorizëm bazohet në **PARANDALIM**. Koncepti i parandalimit në thelb ka një perspektivë të gjerë që përfshin sigurimin e kushteve të mira për zhvillimin, arsimimin dhe edukimin e të rinjve, luftën kundër varfërisë në mënyrë që të sigurohet që të gjithë, pavarësisht nga origjina apo statusi i tyre në shoqëri, të jenë të mbrojtur nga diskriminimi, ndërgjegjësimin publik, por edhe ngritjen e kapaciteteve të institucioneve për një reagim

¹¹ Rezoluta 2396 (2017) u bën thirrje Shteteve Anëtare të forcojnë përpjekjet për të çrrënjësuar rrezikun e rikthimit dhe zhvendosjes së LHT-ve dhe anëtarëve të familjeve të tyre, duke përfshirë gratë dhe fëmijët, përmes kontrollit kufitar, drejtësisë penale dhe masave për shkëmbimin e informacioneve ndërmjet shteteve anëtare dhe organizatave përkatëse si p.sh. INTERPOL-in kur zbulohen LHT-të.

adekuat sepse përpjekjet e përgjithshme parandaluese nënkuptojnë edhe frenimin e përdorimit të mjeteve të dhunshme për arritjen e qëllimeve ideologjike apo fetare.

Kur flitet për parandalim, flitet edhe për një ndërhyrje të caktuar me mjete dhe metoda të përshtatshme.

Strategjia për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm përfshin qëllimet dhe masa strategjike që shërbejnë për arritjen e objektivave në fushën e parandalimit parësor, dytësor dhe terciar.

Parandalimi primar: Aktivitetet e parandalimit parësor në përgjithësi përfshijnë publikun e gjerë dhe kanë të bëjnë me ndërgjegjësimin, zhvillimin e aftësive ndërkulturore dhe trajnimin për profesionistët, por edhe për grupet e ndryshme në komunitet.

Parandalimi dytësor: Ka për qëllim një grup të vogël ose individë në rrezik nga radikalizimi që shpien drejt terrorizmit ose ushtrimit të ekstremizmit të dhunshëm. Masat parandaluese dytësore përfshijnë trajnime për rezistencë dedikuar grupeve të ndryshme në komunitet, masa për të zvogëluar polarizimin dhe punën në terren me individë ose grupe të mundshme në rrezik.

Parandalimi terciar: Ka për qëllim të parandalojë recidivizmin dhe prandaj masat u drejtohen individëve që tashmë janë radikal ose kanë qenë ekstremist të dhunshëm. Parandalimi terciar përfshin personat që nxisin dhunë edhe pse nuk marrin pjesë në akte të dhunshme, si dhe personat e dënuar që janë duke vuajtur dënimin me burg.

Kërcënimi i ekstremizmit dhe radikalizimit nuk është vetëm një problem sigurie (rrezik nga terrorizmi, etj.), por ka edhe implikime më të gjera në lidhje me mirëqenien në kuptimin e kohezionit social dhe mirëqenies në shoqërinë tonë.

Republika e Maqedonisë së Veriut ka harmonizuar dy Strategjitë Kombëtare dhe Planet e Veprimit për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit në katër (4) **PRIORITETET STRATEGJIKE** të përbashkëta në vijim:

1. **PARANDALIMI** i radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm që mund të çojë në terrorizëm përmes identifikimit të hershëm të personave të radikalizuar dhe zbulimit të shkaqeve dhe faktorëve në komunitet që radikalizojnë dhe që çojnë në rekrutimin e qytetarëve për t'iu bashkuar luftëtarëve të huaja terrorist;
2. **MBROJTJA** - e jetës dhe pronës, të drejtave dhe lirive të njeriut dhe dinjitetit të njerëzve, sigurimi i kufijve të jashtëm, përmirësimi i sigurisë në transport, ngjarjet publike dhe zvogëlimi i cenueshmërisë së infrastrukturës kritike.
3. **ZBATIMI** - përmirësimi i bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacioneve ndërmjet institucioneve për të parandaluar radikalizimin dhe ekstremizmin e dhunshëm që mund të çojnë në terrorizëm
4. **PËRGJIGJJA** – veprim aktive, transparente në mënyra që minimizojnë pasojat e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm që mund të çojnë në terrorizëm, duke ngritur shkathtësitë e institucioneve për përfshirjen e tyre aktive në procesin e riintegritimit të personave të radikalizuar dhe duke i trajtuar nevojat e viktimave.

9. QËLLIMET DHE MASAT STRATEGJIKE

Qëllimet dhe masat strategjike janë në funksion të zbatimit të prioritetëve strategjike

1. PARANDALIMI

Ndërtimi i besimit është i një rëndësie të madhe në programet e parandalimit, rehabilitimit dhe riintegritit.

QËLLIMI STRATEGJIK 1.1 Ngritja e kapaciteteve institucionale

Është e nevojshme që vazhdimisht të zhvillohen kompetencat e profesionistëve që punojnë në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, veçanërisht të profesionistëve të linjës së parë (first line responders). Kjo përfshin njohuri të përgjithshme për radikalizimin dhe ekstremizmin e dhunshëm në kontekst kombëtar, por edhe më gjerë në nivel ndërkombëtar, faktorët motivues (të ashtuquajturit faktorët push/pull), njohuri për masat efektive parandaluese.

Masat për zbatimin e qëllimeve strategjike:

- Zhvillimi i kompetencave të profesionistëve (programet e zhvilluara dhe trajnimet e kryera për punonjësit e policisë, stafin mësimdhënës, punonjësit socialë, punonjësit shëndetësorë, punonjësit në institucionet penalo-korrektuese dhe edukative-korrektuese dhe zyrat e probacionot për njohjen e shenjave që janë tregues radikalizimi, si dhe për parandalimin e radikalizimit të mëtejshëm të personave që janë në një program riintegriti) në përputhje me të drejtat e njeriut dhe një qasje të bazuar në respektimin e barazisë gjinore dhe moshës;
- Forcimi të konceptit të parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm përmes policimit në komunitet si dhe afirmimi i mënyrave të dobishme për bashkëpunimin në komunitet.
- Forcimi të kompetencave për punonjësit e shërbimeve të sigurisë përmes trajnimeve të specializuara, me qëllim monitorimin e trendeve, rreziqeve dhe kërcënimeve, si dhe trajnimeve për sigurimin adekuat të provave (prova materiale dhe digjitale).
- Ngritje të kapaciteteve për punonjësit dhe anëtarët e KKPEDhLKT-së përmes zhvillimit të vazhdueshëm profesional, pjesëmarrjes në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, monitorimit të trendeve të reja në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, shkëmbimit të përvojave për masa efektive parandaluese për parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm që shpie në terrorizëm.
- Hulumtim për vlerësimin e nevojave (faktorët që kontribuojnë në radikalizimin dhe sjelljen e dhunshme ekstremiste (konteksti kombëtar, ndikimet rajonale dhe ndërkombëtare) si dhe aspektet e gjinisë dhe moshës në përcaktimin e nevojave në procesin e riintegritit të LHT dhe anëtarëve të familjes së tyre; dhe
- Konferenca vjetore kombëtare për të debatuar çështjet aktuale që kanë të bëjnë me radikalizimin dhe ekstremizmin e dhunshëm që mund të çojnë në terrorizëm, duke përfshirë

çështjet e ekstremizmit kombëtar dhe fetar, si dhe procesin e riintegrit të LHT-ve dhe anëtarëve të familjeve të tyre

QËLLIMI STRATEGJIK 1.2 Ngritja e ndërgjegjësimit të publikut

Kuptimi, njohja dhe ndërgjegjësimi mbi radikalizimin dhe ekstremizmin e dhunshëm që shpie drejt terrorizmit mund të rrisë nivelin e veprimit parandalues në komunitet. Krijimi i materialeve edukative dhe informuese mund të jetë i rëndësishëm për ngritjen e ndërgjegjësimit publik. Është e rëndësishme të parashikohet grupi i synuar për veprim në mënyrë që të mundësohet ndikimi mbi grupet në rrezik (të rinjtë, personat në rrezik social dhe ekonomik, grupet e marginalizuara, etj.). Materiale të tilla janë pjesë përbërëse e disa fushatave, tribunave dhe debateve.

Nevojiten kundër-narrativa, përkatësisht narrativa pozitive për një identitet kombëtar gjithëpërfshirës që e përjashtojnë diskursin "ne dhe ata", por duke përfshirë diskursin "ne" në formësimin e identitetit dhe forcimin e ndjenjës së përkatësisë në mesin e komuniteteve të marginalizuara.

Masat për zbatimin e objektivit strategjik:

- Përgatitje të një fushate kombëtare për parandalimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm që mund të çojë në terrorizëm.
- Promovim të aplikacionit "RED BUTTON" veçanërisht për denoncimin e dhunës, gjuhës së urrejtjes dhe krimit nga urrejtja.
- Mundësi për vendosjen e një numri telefonik falas për ofrimin e informacioneve të dobishme për institucionet për parandalimin e radikalizimit.
- Zhvillim të një modeli referimi për personat e radikalizuar të identifikueshëm për profesionistët dhe familjet.
- Tribuna dhe debate mbi multikulturalizmin dhe promovimin e dialogut ndërfetar dhe ndërkulturor përmes aktiviteteve që promovojnë vlera dhe qëndrime pozitive për diversitetin ndërmjet grupeve dhe komuniteteve të ndryshme kulturore.
- Fushatë mediatike mbi kohezionin social dhe përballimin e ekstremizmit të dhunshëm.
- Trajnim të gazetarëve dhe punonjësve të mediave për identifikimin e hershëm të shenjave të ekstremizmit të dhunshëm që mund të çojnë në terrorizëm
- Trajnim të gazetarëve dhe punonjësve të mediave për të krijuar narrativa pozitive gjatë raportimit për tema të ekstremizmit të dhunshëm dhe promovimin e riintegrit dhe rehabilitimit të LHT-ve të rikthyer dhe familjeve të tyre.

QËLLIMI STRATEGJIK 1.3 Komunitete të forcuara dhe rezistente

Parandalimi është i realizueshëm vetëm në komunitetet që janë rezistente ndaj radikalizimit që shpie në terrorizëm. Të gjitha subjektet në komunitet që mund të veprojnë në fushën e parandalimit janë të rëndësishme. Grupet e dhunshme ekstremiste shfrytëzojnë ndasitë në komunitet që lindin nga jotoleranca fetare, kombëtare, sociale apo të tjera. Komunitetet kohezive dhe gjithëpërfshirëse janë më rezistente ndaj propagandës së ekstremizmit të dhunshëm sesa komunitetet jofunksionale.

Të rinjtë dhe grupet e marginalizuara janë grupe me të cilat duhet të punohet në mënyrë intensive

për të parandaluar mundësinë e indoktrinimit ose radikalizimit të tyre nga grupet ekstremiste.

Masat për realizimin e qëllimit strategjik:

- Zhvillim të dialogut për ndërtimin e besimit ndërmjet përfaqësuesve të vetëqeverisjes lokale, policisë, punonjësve social, arsimit, bashkësive fetare, shoqatave të qytetarëve dhe aktorëve të tjerë të rëndësishëm për parandalimin radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm që shpiejnë në terrorizëm. Këshillat Lokale të Parandalimit janë një mjet i përshtatshëm për të nxitur dialogun.
- Ngritje të kapaciteteve të Ekipeve të Veprimit në Komunitet (EVK) dhe zhvillim të planeve lokale të veprimit.
- Formim të ekipeve të reja të veprimit në komunitet (EVK).
- Përfshirja e të rinjtë përmes formave tashmë të njohura – zyrat rinore dhe qendrat rinore.
- Ngritje të kapaciteteve të prindërve në procesin e parandalimit të radikalizimit.
- Puna me të rinjtë përmes formave të edukimit formal dhe joformal.¹²
- Kultura dhe sporti mund të kontribuojnë më tej në parandalimin e radikalizimit dhe forcimin e kohezionit në vend.

QËLLIMI STRATEGJIK 1.4 Parandalimi i radikalizimit online që shpie në terrorizëm

Interneti mund të jetë një arenë për promovimin e ideologjive ekstremiste dhe gjuhës së urrejtjes, si dhe një arenë për radikalizimin dhe rekrutimin e individëve në shoqata ekstremiste. Për këto arsye, është e nevojshme të forcohen kapacitetet për parandalimin e radikalizimit dhe rekrutimit përmes internetit. Njëkohësisht, interneti mund të jetë një mjet edhe për parandalimin e radikalizimit.

Masat për zbatimin e objektivit strategjik:

- Parandalim të gjuhës së urrejtjes në internet.
- Fushatë për kohezionin social dhe parandalimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm përmes mediave sociale.
- Zhvillim të politikave të bazuara në kërkime, hartëzim të rrezikut, analizë të mundësive për radikalizëm që shpie drejt terrorizmit nëpërmjet internetit.
- Hulumtime mbi edukimin mediatik në mesin e të rinjve me rekomandime.

¹² Masat në fushën e punës me të rinjtë i referohen masave të Strategjisë Kombëtare për të Rinjtë 2016-2025.

QËLLIMI STRATEGJIK 2.1 Institucione proaktive për mbrojtjen e vlerave themelore, të drejtave dhe lirive të njeriut dhe rritjen e besimit të qytetarëve ndaj institucioneve.

Forcimi i përgjigjes kundër terrorizmit duhet të përfshijë parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çojnë në terrorizëm. Në këtë kuptim, të drejtat që i referohen integritetit të personit: e drejta për jetë, liri dhe siguri janë të drejta themelore që shteti është i detyruar t'u sigurojë qytetarëve të tij.¹³ Shteti ka detyrimin të respektojë, mbrojë dhe garantojë të drejtat e individit. Ekziston një lidhje e fortë ndërmjet sigurimit të rendit dhe qetësisë publike, mbrojtjes së qenieve njerëzore dhe të drejtave dhe lirive themelore.

Masat për zbatimin e qëllimit strategjik

- Mbrojtja e njerëzve në vende publike, sidomos kur flasim për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, jetës dhe pronës së qytetarëve. Është e një rëndësie të veçantë përfshirja e një partneriteti publiko-privat me komunitetin e biznesit, duke përfshirë agjencitë private të sigurisë, veçanërisht me ato që ofrojnë shërbime për sigurinë e vendeve publike ku mund të frekuentohen nga një numër i madh qytetarësh (qendra, qendra transport, shkollat ose objektet që ofrojnë shërbime akomodimi);
- Ngritje të kapaciteteve të ekipeve lokale multidisiplinare për të punuar me personat e radikalizuar, LHT-të dhe anëtarët e familjeve të tyre.
- Puna me grupet e cënueshme të qytetarëve duke ofruar ndihmë dhe masa mbrojtëse.
- Vizibilitet më i madh i KKPEDhLKT-së me qëllim promovimin e koncepteve të parandalimit dhe mbrojtjes kundër radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm që mund të çojë në terrorizëm.

¹³ Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, 10 dhjetor 1948

3. ZBATIMI

QËLLIMI STRATEGJIK 3.1 Masat për mbrojtjen e kufirit

Të vepruarit proaktiv i institucioneve, veprimet e përbashkëta dhe rrjetëzimi i institucioneve është një garanci e fortë për ngritjen e një sistemi funksional. Monitorimi dhe analiza e gjendjes së kriminalitetit në lidhje me armët, municionet dhe eksplozivët,¹⁴ monitorimi i flukseve të migracionit të brendshëm dhe të jashtëm janë bazat e politikave të bazuara në prova dhe vlerësimeve të duhura të rrezikut.

Masat për zbatimin e objektivit strategjik:

- Krijim të një sistemi efikas për regjistrimin e vendbanimit të shtetasve të huaj në Republikën e Maqedonisë së Veriut.
- Analiza të flukseve të migrantëve dhe ndikimeve në shfaqjen e lëvizjeve ekstremiste dhe radikalizimit që çojnë në terrorizëm.

➤ PËRGJIGJJA

QËLLIMI STRATEGJIK 4.1 Shkëputja(mosangazhim)/Deradikalizimi

Programet e mosangazhimit/deradikalizimit janë thelbësore në procesin e parandalimit terciar. Riintegrimi i ekstremistëve të dhunshëm, terroristëve, LHT mund të konsiderohet një proces që synon të lehtësojë riintegrimin e tyre në shoqëri, duke ulur kështu gjasat që ata të vazhdojnë me veprime të dhunshme.

Procesi i shkëputjes(mosangazhimit) dhe de-radikalizimit të personave të radikalizuar është një proces që kërkon një qasje individuale, qasje gjinore, si dhe të përshtatshme në bazë të moshës dhe është një proces i bazuar në respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonia e Veriut dhe ligji ndërkombëtar për të drejtat e njeriut.

Masat për zbatimin e qëllimit strategjik:

- Përfshirja në një program riintegrimi nëpërmjet rehabilitimit të personave të dhunshëm radikal në Institucionet Ndëshkimore e Korrektuese (INK), puna me personat pas lirit nga burgu dhe familjet e LHT-ve.
- Analizë të mundësive për përfshirjen e bashkësive fetare në procesin e rehabilitimit dhe riintegrimin të personave të dënuar.

¹⁴ Lidhur me Udhërrëfyesin për një zgjidhje të qëndrueshme për posedimin, keqpërdorimin dhe tregtinë e paligjshme të armëve të zjarrit dhe municioneve të armëve të vogla dhe të lehta (SALW) për të njëjtën gjë në Ballkanin Perëndimor deri në vitin 2024.

- Përfshirje në një program riintegrimi nëpërmjet rehabilitimi
- Të reduktojë rreziqet/faktorët që kontribuojnë në radikalizimin që shpien në terrorizëm ose dhunë në institucionet ndëshkuese korrektuese (INK), të përmirësojë kushtet e paraburgimit dhe të sigurojë respektimin e të drejtave të njeriut në trajtimin e të burgosurve ekstremistë, duke përfshirë rritjen e mbikëqyrjes së burgjeve dhe forcimin e kapaciteteve të monitorim të pavarur;
- Përmirësimi i kapaciteteve në Institucionet Ndëshkimore e Korrektuese (INK).

Trajtimi i anëtarëve të familjes kërkon një qasje gjinore dhe një qasje të bazuar në parimin e interesit më të mirë të fëmijës.

QËLLIMI STRATEGJIK 4.2 Riintegrimi nëpërmjet risocializimit dhe rehabilitimit

Riintegrimi luan një rol kryesor në procesin e parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm. Përmes programeve të duhura për risocializim dhe rehabilitim do të lehtësohet procesi i riintegrit të personave të radikalizuar në komunitet. Për këtë qëllim nevojitet një qasje gjithëpërfshirëse, e cila do të bazohet në nevojat individuale të personit/personave të përfshirë në program. Është e rëndësishme të merret parasysh qasja ndaj grave dhe fëmijëve të rikthyer në procesin e riintegrit sepse ato mund të kenë status të dyfishtë – të autorëve dhe të viktimave. Prandaj, njohuritë për traumën duhet të jenë një aftësi kryesore që duhet ta kenë individët që punojnë me fëmijët e rikthyer.

Masat për realizimin e qëllimit strategjik:

- Punë me gratë dhe fëmijët e rikthyer përmes programeve të ndjeshme gjinore dhe programeve që do të ndjekin interesin më të mirë të fëmijës.
- Zhvillim dhe zbatim të programeve për punën me fëmijët në institucionet edukativo- korrektues.
- Zhvillim dhe zbatim të programeve për punë me persona të dënuar në INK.
- Zbatim të procedurave dhe rregulloreve të përcaktuara me PSO(procedura standarde operative) për trajtimin e LHT dhe anëtarëve të familjeve të tyre me anë të zbatimit të PSO(procedura standarde operative) për asistencë para dhe pas lirim të personave të dënuar e të radikalizuar.
- Zbatimi i një programi për arsimin (jo)formal dhe formimin profesional të personave të dënuar mbetet një masë e rëndësishme për uljen e shkallës së radikalizimit të personat të cilët vullnetarisht i bashkohen një programi të formimit profesional.

QËLLIMI STRATEGJIK 4.3 Forcimi i koordinimit dhe avancimi i bashkëpunimit

Procesi i rehabilitimit, risocializimit dhe riintegrit të personave të radikalizuar dhe "shpërqendrim" i tyre nga veprimet e mëtejshme mbështetet në një përgjigjeje të gjërë shoqërore. Bashkëpunimi bazohet në mësimet e fituara dhe aktivitetet e udhëhequra nga praktikat më të mira, por edhe në programe të përbashkëta për veprim në nivel kombëtar dhe rajonal.

Masat për zbatimin e qëllimit strategjik:

- Forcim të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve, bashkëpunim me shoqatat civile si partnerë për arritjen e qëllimeve strategjike, me organizatat ndërkombëtare dhe me partnerë nga vendet e rajonit; dhe
- Zbatim të plotë të Planit të Përbashkët të Veprimit Kundër Terrorizmit për Ballkanin Perëndimor, duke përfshirë integrimin e mëtejshëm të rajonit në aktivitetet e Rrjetit të Ndërgjegjësimit për Radikalizimin (RAN) gjë që është thelbësore.

10. PRIORITETET PËR ZBATIM

Prioritetet për zbatim janë përcaktuar duke ndjekur planin e veprimit për zbatimin e Strategjisë për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm 2023-2027.

Në këtë drejtim, aktivitetet e mëposhtme përcaktohen si aktivitete prioritare:

1. Ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore përmes formave të ndryshme të trajnimit (si aktivitet i vazhdueshëm).
2. Futja e një detyre mësimore në programin e trajnimit bazë për kandidatët e oficerëve të policisë.
3. Promovimi i konceptit të Këshillave Vendore të Parandalimit dhe sigurimi i vazhdimësisë dhe mbështetjes për hartimin e strategjive lokale për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që shpie në terroizëm.
4. Hartëzimi dhe analiza e shfaqjes së radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm që shien në terrorizëm në internet, në hapësirën e Republikën e Maqedonisë së Veriut
5. Mbështetja e aktiviteteve për punën me familjet e cënueshme.
6. Zhvillimi i një instrumenti për vlerësimin e radikalizimit të fëmijëve në institucionet edukativo korrektuese.
7. Zhvillimi i një programi për rehabilitimin, risocializimin dhe riintegrimin për të kthyer nga ushtritë e huaja dhe anëtarëve të familjeve të tyre, grave dhe fëmijëve në sistemin e mbrojtjes dhe sigurisë sociale.
8. Krijimi i një sistemi monitorimi, koordinimi dhe evidentimi të ndihmës dhe mbështetjes për personat e radikalizuar të përfshirë në programin e riintegritit nëpërmjet rehabilitimit dhe risocializimit, duke përfshirë LHT-të dhe anëtarët e familjeve të tyre.
9. Zhvillimi e një mënyre për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm.
10. Aktivitete me target grupet - të rinjtë me qëllim zhvillimin e të menduarit kritik.
11. Aktivitete me target grup të grave dhe përfshirja e tyre aktive në aktivitetet parandaluese për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm.

11.MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të strategjisë dhe planit të veprimit kryhet nga KKPEDhLKT në bashkëpunim me organet kompetente shtetërore. Shoqatat përkatëse civile dhe organizatat ndërkombëtare janë partnerë në zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm (2023-2027), si dhe partner në monitorim duke përfshirë ndikimin e mundshëm për të drejtat e njeriut dhe zbatimin e tij.

Realizimi i qëllimeve të kësaj strategjie do të mbështetet financiarisht nga buxhetet e institucioneve shtetërore. Subjektet shtetërore janë të udhëzuara që të vendosin bashkëpunim për shfrytëzimin e mbështetjes shtesë financiare, ekspertë dhe institucionale nga fondet e BE-së, OSBE-së, OKB-së dhe organizatave të tjera ndërkombëtare

KKPEDhLKT koordinon procesin e arritjes së qëllimeve të Strategjisë për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm, si dhe harmonizimin e aktiviteteve me dokumente të tjera strategjike. Në të njëjtën kohë, KKPEDhLKT monitoron zbatimin e Planit të Veprimit të kësaj strategjie dhe i jep rekomandime Qeverisë së RMV-së për marrjen e masave të duhura në rast moszbatimi ose vështirësish në zbatim.

Monitorimi i strategjisë nënkupton mbledhjen e të dhënave për shkallën e realizimit të aktiviteteve dhe përcaktimin e rreziqeve të mundshme që mund të lindin nga aktivitetet e përealizuara ose nga rezultatet e paarritura. Në situata të caktuara matet edhe ndikimi i masave dhe aktiviteteve të caktuara në ndryshimin e situatës (përmes paraqitjes së duhur dhe objektivit të treguesve të suksesit).


Gjatë hartimit të raporteve do të merren parasysh parimet vijuese: përpikëria dhe qartësia; rëndësia; objektiviteti, si dhe informacionet përfshijnë aspektin cilësor dhe sasior.

Trupi koordinues do të prezantojë raportin vjetor për shkallën e realizimit, treguesit e suksesit dhe pengesat për realizimin e qëllimeve strategjike në një seancë të KKPEDhLKT-së.

Çdo dy vjet, konsulent e pavarur bëjnë një analizë të progresit të zbatimit të qëllimeve strategjike dhe ia dorëzojnë raportin KKPEDhLKT-së

Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm

Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm përmes zhvillimit gjithëpërfshirës, promovimit të tolerancës dhe respektimit të diversitetit.



LISTA E SHKURTESAVE (të përdorura në Strategjinë për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Planin e Veprimit për zbatimin e Strategjisë)

AShMAA – Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele
ASK – Agjencia e Sigurisë Kombëtare
EVK – Ekipet të Veprimit në Komunitet
BSP – Byroja e Sigurisë Publike
LKT – Lufta Kundër Terrorizmit
IEA – Institucion Edukativo Arsimor
BE – Bashkimi Evropian
BNjVL – Bashkësia e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale
ShG – Shoqatë Gazetarësh
INK – Institucion Ndëshkimor e Korrektues
KMKFGR - Komisioni për Marrëdhënie me Komunitetet Fetare dhe Grupet Religjioze
EML – Ekipet Multidisiplinare Lokale
KLP – Këshilla Lokal të Parandalimit
MPB – Ministria e Punëve të Brendshme
MeM – Ministria e Mbrojtjes
MASH – Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MPPS – Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
EDh – Ekstremizëm i Dhunshëm
KKPEDHLKT – Komiteti Kombëtar për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit
OSBE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
KB – Kombet e Bashkuara
KEM – Këshilli për Etikën në Media
PEDh – Parandalim të Ekstremizmit të Dhunshëm
LHT – Luftëtarë të Huaj Terroristë
KE – Këshilli i Evropës
PCM – Republika e Maqedonisë së Veriut
RRR – Rehabilitim, Risocializim, Riintegrim
PSV – Procedurë Standarde e Veprimit
QPS – Qendra për Punë Sociale